



**EKZEKUTIMI I
VENDIMEVE TË GJYKATËS
KUSHTETUESE
DHE ROLI I RËNDËSISHËM
I TYRE NË FORCIMIN E
SHTETIT TË SË DREJTËS**

Tiranë, 2008

RAPORT
REZULTATET E MONITORIMIT TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË
GJYKATËS KUSHTETUESE

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të
Fondacionit Shoqëria e Hapur Soros

Përgatiti: Dr. Tefta Zaka

Redaktor: Marie Mati

Art Grafik& Kopertina: Elvira Çiraku

Shtypur në Shtypshkronjën AlbPAPER

Hyrje

Projekti për nxitjen e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës kushtetuese kaloi në disa faza, më e rëndësishme nga të cilat ishte ajo e monitorimit të vendimeve të kësaj gjykate dhe evidentimi i problemeve që kanë dalë në ekzekutimin e tyre.

Fillimisht u bë analiza e kuadrit ligjor që përfshin kompetencat e gjykatës kushtetuese, efektet juridike të vendimeve që ajo merr, si dhe evidentimi i bazës kushtetuese e ligjore ku mbështetet ekzekutimi i vendimeve të saj.

Kjo analizë pati në konsideratë faktin se kontrolli kushtetues përbën një element të rëndësishëm që ndikon në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe se gjykata kushtetuese është i vetmi organ kompetent në fushën e drejtësisë kushtetuese, gjë që e bën edhe më të rëndësishëm ekzekutimin me efikasitet të vendimeve të saj.

Aspekti i dytë i kësaj analize konsistoi në studimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese gjatë pesë vjetëve (2002-2007), nga ku u përzgjedhën vendimet më të rëndësishme, të zbatuara, por, në veçanti, ato të paekzekutuara, të cilat do të analizohen hollësisht në vijim.

Meqenëse llojet, objekti i kontrollit kushtetues si edhe efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë të lidhura ngushtësisht me ekzekutimin e tyre, në radhë të parë mendohet se është e nevojshme të bëhet një trajtesë e shkurtër e këtyre koncepteve, përpara se të analizohet në mënyrë të detajuar procesi i monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke u fokusuar më tepër në atë pjesë të kontrollit kushtetues që ka të bëjë me vendimet e përzgjedhura dhe që lidhen me organet kryesore kushtetuese dhe me rolin që ato kanë luajtur në këtë proces.

1. Gjykata Kushtetuese - organi që ushtron drejtësinë kushtetuese

Për të kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka krijuar një organ që ka karakteristikat e veta, si nga struktura, ashtu edhe nga funksionet dhe që e bëjnë atë një autoritet të veçantë kushtetues. Gjykimi i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare përpara ratifikimit, kushtetutshmëria e partive politike, gjykimi i lejueshmërisë kushtetuese të referendumit, verifikimi i rezultatit të tij si dhe verifikimi i zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe i deputetëve, mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, gjykimet në lidhje me shkarkimin e Presidentit të Republikës dhe të gjyqtarëve të lartë e, në veçanti, shqyrtimi i ankesave të individëve për shkeljen e së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave, i janë besuar pikërisht Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të një pozicioni të tillë që ka, Gjykata Kushtetuese garanton jo vetëm respektimin e Kushtetutës, por është edhe autoriteti më i lartë kushtetues që bën interpretimin përfundimtar të saj.

Juridiksioni kushtetues e ka pikënisjen në nenin 131 të Kushtetutës të ndërthurur dhe me dispozita të tjera të saj. Të gjitha këto funksione i japin Gjykatës Kushtetuese forcë dhe epërsi në raport me organet e tjera, pozicion ky që rrjedh nga roli që ajo kryen si organ i ngarkuar për të mbrojtur Kushtetutën.

Në përgjithësi, vërehet se, në sistemin politik aktual, Gjykata Kushtetuese ka zënë një hapësirë që e karakterizon tashmë si subjekt me pushtet të padiskutueshëm. Pesha e vendimeve të saj të paapelueshme, rëndësia që marrin arsyetimet e vendimeve, kanë bërë që ajo të marrë një rol zotërues që nuk parapëlqehet lehtë. Janë këto funksione të rëndësishme që i janë ngarkuar këtij autoriteti kushtetues, të

cilat garantojnë dhe e bëjnë praktikisht veprues parimin e kushtetutshmërisë. Pra, kjo krijon fizionominë e një sistemi me kushtetutë të ngurtë dhe që kërkon një organ të tillë për të ushtruar drejtësinë kushtetuese.

2. Baza ligjore për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Kjo analizë synon parashtrimin e përmbledhur të bazës ligjore që rregullon çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. Analiza fokusohet vetëm në parashtrimin e atyre normave që zbatohen për çështjen objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, vlen të theksohet që në fillim se pjesë e kësaj analize është vetëm parashtrimi i kuadrit ligjor të zbatimit të tyre dhe jo trajtimi i mënyrës se si janë dhënë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Dispozitat në të cilat mbështetet zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë gjenden në tekstin e Kushtetutës, në akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të organeve të tjera shtetërore. Kështu, kuadri ligjor i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të Kuvendit Popullor si dhe me referendum, më datën 22.11.1998 dhe shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007.
- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".
- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë normat parësore që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 124 i Kushtetutës nxjerr në pah funksionin kryesor të Gjykatës Kushtetuese që është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj. Rregulla kushtetuese, sipas së cilës ky organ *i nënshtrohet vetëm Kushtetutës*, është tepër domethënëse për të kuptuar epërsinë e këtij organi, por edhe të vendimeve që ai merr, mbi të gjitha organet e tjera.

Në nenin 132 është sanksionuar fuqia detyruese e përgjithshme dhe përfundimtare e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet së cilës garantohet vetëzbatueshmëria e tyre. Këto dispozita kushtetuese kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pasi fuqia detyruese e përgjithshme dhe e pakontrollueshme e këtyre vendimeve, nga asnjë organ tjetër kombëtar, ka si objekt final garantimin e respektimit të Kushtetutës nga të gjitha subjektet shtetërore apo joshtetërore, pa përjashtim.

Hyrja në fuqi e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kushtëzohet me botimin e tyre në Fletoren zyrtare, është një tjetër rregullim kushtetues, nëpërmjet të cilit sanksionohet forca detyruese e këtyre vendimeve. Këto vendime janë të detyrueshme për çdo institucion kushtetues e ligjor, pa përjashtuar nga ky detyrim as gjykatat. Sipas nenit 145 të Kushtetutës, "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat."

Janë këto rregullime kushtetuese që e kanë gjetur pasqyrimin e tyre në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Në nenin 81 të këtij ligji është parashikuar detyrueshmëria për zbatim e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe se për ekzekutimin e tyre ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe organet përkatëse të administratës shtetërore. Gjykatës Kushtetuese i

njihet e drejta të caktojë vetë një organ tjetër për t'u marrë me zbatimin e vendimeve të saj dhe, kur e çmon të nevojshme, mund të përcaktojë edhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit. Ligji i njeh të drejtën edhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese që të ndëshkojë administrativisht me gjobë deri në 100.000 lekë personat që nuk zbatojnë ose që pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

Në dispozita të tjera të këtij ligji, si nenet 76, 77, nuk parashikohen rregulla të drejtpërdrejta që lidhen me ekzekutimin, por vendosen rregullime që lidhen me fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Një tjetër akt që normon rregulla të detyrueshme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë. Në nenin 87 të Rregullores parashikohet :

“1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren zyrtare.

2. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës”.

3. Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Vendimet jepen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të përmbajnë të dhënat, shkaqet, motivet e faktit dhe të së drejtës, datën e vendimit dhe nënshkrimin e gjyqtarëve.

Një normim i këtillë i efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese afirmon qartazi se ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme (*erga omnes*) dhe janë përfundimtare. Po ashtu, në këtë dispozitë kushtetuese përcaktohen edhe disa modalitete praktike që lidhen me publicitetin dhe marrjen dijeni të publikut për vendimet e Gjykatës Kushtetuese si dhe momentin e hyrjes në fuqi të tyre. Kështu, parashikohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare. Në funksion të faktit se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin, por forca detyruese dhe përfundimtare i përket gjithnjë vendimit të marrë nga shumica.

Kundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk pranohet asnjë kundërshtim. Pra, ato janë përfundimtare. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit, konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet (neni 75 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese). Parashikueshmëria dhe pakundërshtueshmëria e vendimeve (në veçanti e vendimeve të pranimit) lidhet me karakterin e tyre të detyrueshëm dhe përfundimtar.

Vetëm në raste paqartësie, plotësimi ose interpretimi, si dhe të ekzistencës së gabimeve materiale të vendimeve, Gjykata merr masa të korigjojë vendimin e saj me një vendim të dhënë në seancë plenare, në prani të palëve. Megjithatë, edhe me këtë vendim, Gjykata nuk mund të anulojë ose të ndryshojë vendimin e saj. Në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, ajo ka të drejtë të interpretojë vendimin, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen, të plotësojë vendimin a të ndreqë gabimet me shkrim në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të. Kjo kërkesë duhet të ushtrohet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

Në nenin 145 të Kushtetutës përcaktohet qartë se

detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk kufizohet as për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ky nen përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat. Një dispozitë e tillë kushtetuese nuk është gjë tjetër veçse një riafirmim i forcës detyruese (*erga omnes*) të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por tashmë drejtuar në mënyrë specifike te gjykatat (*gjykatave të shkallës së parë, të apelit dhe Gjykatës së Lartë*). Pra, të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për të gjitha çështjet me të cilat ato kanë lidhje.

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke qenë se është ligj organik, rregullon aspekte mjaft të rëndësishme të karakterit procedural në lidhje me veprimtarinë efektive të Gjykatës Kushtetuese. Që në nenin 1 të tij përcaktohet se objekt i ligjit është edhe përcaktimi i rregullave bazë që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Neni 26 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", konfirmon fuqinë juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ky nen përcakton edhe rregullën se, kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.

Tepër i rëndësishëm paraqitet edhe parashikimi ligjor, sipas të cilit, organi që merret me botimin e Fletores zyrtare, detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese jo më vonë se 15 ditë nga ardhja e tyre për botim pranë tij. Një rregull e tillë mundëson publikimin dhe bërjen të njohur për publikun dhe organet shtetërore, në një kohë të shkurtër, të përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese që është shprehur për një çështje të caktuar. Ky detyrim është i lidhur me rregullën që parashikohet në Kushtetutë, sipas së

cilës vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare.

Neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", parashikon disa modalitete të posaçme që lidhen me rastin kur Gjykata Kushtetuese urdhëron pezullimin e zbatimit të ligjit ose të aktit. Ky pezullim vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Kjo dispozitë ligjore paraqet rëndësi të veçantë dhe lidhet drejtpërdrejt me zbatueshmërinë e vendimeve të ndërmjetme të Gjykatës Kushtetuese. Ndonëse ligji nuk e përdor një terminologji të tillë, vendimi me efekt pezullues merret nga Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerësohet se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë, sipas rastit, pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve.

Shqyrtimi i pajtueshmërisë së normës juridike me Kushtetutën shihet i lidhur me efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Forma e kontrollit kushtetues paraqitet në aspektin anulues (*ex tunc*) si dhe në aspektin shfuqizues (*ex nunc*). Këto forma lidhen me efektet juridike të vendimeve të gjykatës.

Ky koncept doktrinar i efekteve juridike të vendimeve gjyqësore ka gjetur shprehjen e tij në nenin 76 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese". Sipas kësaj dispozite, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këto raste është shfuqizues (*ex nunc*). Për rrjedhojë, efektet e tij fillojnë përgjithësisht nga data e hyrjes së vendimit në fuqi. Përgjithësisht nga kjo rregull, vendimi i Gjykatës Kushtetuese paraqitet si anulues dhe ka fuqi prapavepruese në tri raste që kanë të bëjnë me një dënim penal, kur ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, vendimet e të cilave nuk kanë marrë formë të prerë, si dhe ndaj pasojave ende të pashterura të ligjit. Termat në latinisht *ex nunc* dhe *ex tunc* nuk përdoren shprehimisht në ligjin e Gjykatës Kushtetuese, por, nga mënyra e formulimit

të dispozitës konkrete, konkludohet për këto dy forma juridike që marrin vendimet gjyqësore.

Megjithatë, duhet vënë në dukje se Gjykata Kushtetuese e ka të kufizuar efektin prapaveprues të vendimeve të saj të pranimit, për arsye se një zbatim rrënjësor dhe i përgjithësuar me efekt *ex tunc* i një tipi të tillë vendimi mund të prodhojë efekte thellësisht tronditëse në planin social ose detyrime ekonomike të papërbalueshme, në krahasim me situata të kristalizuara prej kohësh. Ky është një qëndrim që njihet pothuajse në shumë vendime të gjykatave kushtetuese europiane.

Nga ana tjetër, në nenin 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", përcaktohet se, në rastin e shfuqizimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, këto vendime nuk do të kenë më fuqi që nga çasti i marrjes së tyre dhe, për pasojë, çështja i dërgohet për rishqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është shfuqizuar.

Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në nenin 78 të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet organeve përkatëse me qëllim që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj. Ky njoftim është pjesë e detyrimit që kanë organet të cilave u drejtohet vendimi, për të bërë ekzekutimin e detyrimeve të rrjedhura prej tij. Është e qartë se, në rastin e shfuqizimit të një dispozite ligjore apo të një ligji, kur lënda mbetet e parregulluar ligjërisht, është detyrë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të nxjerrë ligjet përkatëse zëvendësuese që duhet të jenë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese nuk urdhëron ligjvënësin të plotësojë normën ligjore përkatëse. Sidoqoftë, në ato raste kur ka diktuar se, si rrjedhojë e një vendimi

shfuqizues, ometimi ligjor në vetvete përbën antikushtetutshmëri, ajo e ka pasqyruar këtë si pjesë të vendimit, nëpërmjet arsyesimit.

Efekt tjetër i rëndësishëm *ex tunc* që u jepet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe që ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e tyre, lidhet me vendimet që jep Gjykata Kushtetuese për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë efekt prapaveprues.

Gjykata Kushtetuese bën interpretimin e detyrueshëm dhe përfundimtar të Kushtetutës, duke vepruar si një trupë gjyqësore e ndarë dhe e pavarur nga autoriteti legjislativ. Në këndvështrimin e ndarjes së pushteteve, interpretimi që bën Gjykata Kushtetuese nuk është dhe nuk mund të jetë krijim i normave ligjore ose kushtetuese. Në pajtim me parimet kushtetuese, ajo jep kuptimin e saktë e të rregullt të normave ligjore të shprehura në dispozitat përkatëse, ndërkohë që zbaton rregullat e interpretimit, të pranuar në një kulturë ligjore, të përfshirë në rregullat demokratike të ligjit.

Në vendimet për interpretimin detyrues dhe të përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese zbërthen dyshimet interpretuese të prezantuara tek ajo. Kjo do të thotë se, si rezultat i formulimeve të paqarta, të pasakta ose të paplota të dispozitave, interpretuesi dhe zbatuesi ka ose mund të ketë vështirësi në njohjen e kuptimit aktual të normës ligjore. Kur interpreton dispozitat, Gjykata Kushtetuese merr në konsideratë sistemin e tyre linguistik, përmbajtjen sociale dhe boshtin logjik, si dhe qëllimin e dispozitës.

Në interpretimin e saj, Gjykata Kushtetuese nuk shkon më tutje dhe nuk shton asgjë në sistemin e normave detyruese ligjore. Ajo vetëm shpall, pohon përmbajtjen e këtyre normave. Kështu interpretimi i kryer nga Gjykata Kushtetuese ka vetëm karakter “deklarativ” dhe jo natyrë ligjvënëse. Pushtetet e ndara kushtetuese e detyrojnë atë të bëjë kështu, duke e përjashtuar nga roli i ligjvënësit.

4. Analiza e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Një pjesë e rëndësishme e projektit për nxitjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është analiza e disa vendimeve të përzgjedhura për vitet 2002 – 2007, vetëm për vendimet e pranimi dhe të interpretimit kushtetues. Nga studimi ka rezultuar që në afërsisht 100 vendime pranimi të marra nga Gjykata Kushtetuese në 5 vjet, rreth 12 për qind e tyre janë të paekzekutuara. Pra, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekzekutuar nga organet përkatëse dhe vetëm në pak raste nuk ka gjetur vend ekzekutimi i tyre. Për këtë studim u morën për t'u analizuar vendimet më tipike, të konsideruara si ndër më të rëndësishmet, por që ende nuk janë ekzekutuar.

Qëllimi i këtij studimi nuk është analiza mbi përmbajtjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por analiza e shkaqeve që kanë çuar në moszekutimin e disa prej tyre, si dhe gjetja e rrugëve ligjore për të bërë të mundur që asnjë vendim të mos mbetet i paekzekutuar.

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" parashikon disa mekanizma të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në varësi të objektit si dhe të institucionit që detyrohet t'i zbatojë ato. Nga ky këndvështrim, metodologjia e përdorur në përzgjedhjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka synuar të mbulojë të gjitha institucionet që kanë detyrimin t'i zbatojnë atë, si dhe të gjitha subjektet që kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Kjo analizë shërbeu si material ndihmës në procesin e monitorimit të disa vendimeve të paekzekutuara. Megjithatë u pa e arsyeshme që në këtë analizë të përfshihen edhe disa vendime të ekzekutuara. Trajtimi si pjesë e këtij studimi edhe e disa vendimeve të ekzekutuara ka pasur për qëllim evidentimin e qëndrimeve të ndryshme për ekzekutimin a

mosekzekutimin që ka mbajtur i njëjti organ ndaj vendimmarrjes kushtetuese.

Për secilin vendim të përzgjedhur është bërë një përshkrim i shkurtër i shkaqeve të antikushtetueshmërisë së aktit që kundërshtohet. Është e rëndësishme të theksojmë se kjo mënyrë e analizës së shkaqeve të dhëna në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese është përdorur sepse këto vendime kanë një specifikë në drejtim të ekzekutimit të tyre. Në vendimet e gjykatave të zakonshme ekzekutimi bazohet vetëm në dispozitivin e vendimit dhe organi kompetent e ekzekuton vendimin gjyqësor bazuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Ndërsa, për vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ekzekutimi i shtrin efektet e tij jo vetëm mbi dispozitivin, por edhe mbi pjesën arsyetuese të tij. Vendimi është një dhe i pandarë dhe dispozitivi nuk do të mund të kishte kuptim pa pjesën arsyetuese të vendimit. Sigurisht, kjo vlen për çdo vendim gjyqësor, pavarësisht se cili organ e merr atë vendim, por vendimet kushtetuese kanë një specifikë të ndryshme. Kur Gjykata Kushtetuese e konsideron një dispozitë ligjore si antikushtetuese, plotësimi i boshllëkut ligjor të krijuar do të realizohet nga ligjvënësi apo organi konkret vetëm duke u nisur nga orientimet e dhëna në arsyetimin e vendimit gjyqësor. Në pjesën arsyetuese të vendimit parashtrohen shkeljet dhe jepen argumentet kushtetuese, ku bazohet edhe dispozitivi i vendimit. Pikërisht, interpretimi i vetëm që Gjykata Kushtetuese e quan kushtetues, është ai që është pasqyruar në arsyetimin e vendimit të saj. Pra, arsyetimi i vendimit nuk është gjë tjetër, veçse mënyra për të dhënë të gjitha përgjigjet që janë kërkuar nga pala në objektin e kërkesës. Për rrjedhojë, edhe arsyetimi i vendimit gjyqësor është pjesë e detyrueshme e konceptit të zbatueshmërisë së vendimeve kushtetuese.

Nga analiza e vendimeve kushtetuese, por dhe nga kontaktet me institucionet përkatëse shtetërore konstatohet një sensibilitet i përgjithshëm për vetëzbatueshmërinë e

vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht mosekzistencës së një organi të specializuar për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Kushtetuta parashikon në mënyrë të qartë karakterin detyrues të këtyre vendimeve. Megjithatë konstatohet se ka vendime të cilat nuk kërkojnë veprime të drejtpërdrejta nga organet shtetërore (siç është rasti i shfuqizimit të dispozitave, kur nuk krijojnë boshllëk ligjor), ashtu siç ka edhe raste që organet e detyruara në vendim nuk ndërmarrin ndonjë veprim për ekzekutimin e tyre.

Më poshtë po paraqesim disa nga vendimet e paekzekutuara dhe disa mendime për problematikën që ato kanë sjellë.

I. Vendimi nr. 9, datë 26.2.2007 (V – 9/07)

1.Objekti i vendimit:

“Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 1, 2 (pikat 5 e 6), 7 (shkronjat “a, b”) e 9 të ligjit nr. 9481, datë 16.2.2006, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005, “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

2.Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 1, 7 (shkronjat “a, b”) e 9 të ligjit nr. 9481, datë 16.2.2006, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9418, datë 20.5.2005, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shfuqizimi i dispozitave objekt gjykimi krijon një boshllëk lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet e pleqërisë të ushtarakëve. Bazuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë i rekomandohet të bëjë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Në aspektin e ekzekutimit ndodhemi para një situatë që dispozitivi i vendimit vetëm ka shfuqizuar dispozitat objekt shqyrtimi. A ndodhemi në këtë rast para një vendimi që kërkon ekzekutim?

Në referim të nenit 78 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Nga analiza e këtij vendimi konstatohet se ndodhemi para një vendimi të paekzekutuar, për arsye se boshllëku ligjor i krijuar për shkak të shfuqizimit të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi, duhet të ishte plotësuar. Detyrimi në këtë rast është për Këshillin e Ministrave dhe veçanërisht për Kuvendin e Shqipërisë.

II. Vendimi nr. 16, datë 27.4.2007 (V – 16/07)

1.Objekti i këtij vendimi është : "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr. 154/2, datë 31.3.2004, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 15, datë 29.6.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë".

2.Gjykata Kushtetuese vendosi :

- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 154/2, datë 31.3.2004, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 15, datë 29.6.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- **Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.**

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare.

III. Vendimi nr. 17, datë 12.11.2004 (V – 17/04)

1. Objekt i këtij vendimi është : “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr. 130, datë 27.5.2002, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 83, datë 18.11.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 130, datë 27.5.2002, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 83, datë 18.11.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- **Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.**

IV. Vendimi nr. 11, datë 2.4.2003 (V – 11/03)

1. Objekt i këtij vendimi është : “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 99, datë 20.12.2000, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 25, datë 4.4.2001, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.99, datë 20.12.2000, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 4.4.2001, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- **Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.**

3. Mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Të tria vendimet e sipërpërmendura të Gjykatës Kushtetuese kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që i kanë gjykuar ato, të cilat kanë pasur si objekt shkarkimin e gjyqtarëve nga detyra për shkaqet e analizuara në vendimet e tyre dhe si pasojë e kontrollit të ushtruar në gjykatat përkatëse.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se procesi i zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për shqyrtimin e të tria rasteve të mësipërme ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sipas argumenteve që janë renditur në vendimet e sipërpërmendura.

Në mbrojtje të të drejtave të gjyqtarëve të cenuara nga këto vendime, Gjykata Kushtetuese, pasi ka pranuar kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të KLD-së, ia ka kthyer për rishqyrtim kësaj të fundit.

Nga verifikimi i bërë ka rezultuar se KLD-ja nuk i ka zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të marra përkatësisht në vitet 2003, 2004 dhe 2007, sepse nuk i ka marrë në rishqyrtim këto çështje.

Mosmarrja në rishqyrtim e këtyre çështjeve nga KLD-ja përbën një aspekt të mosekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Me vendimet që ka dhënë kjo gjykatë, ka konsideruar nul të gjithë procesin ligjor të zhvilluar ndaj

gjyqtarëve të shkarkuar nga KLD-ja dhe nga Gjykata e Lartë. Pra, si rrjedhojë e këtyre vendimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese formalisht ndaj gjyqtarëve nuk rezulton ndonjë masë disiplinore e dhënë. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin e KLD-së që ka dhënë masën, e ka konsideruar të parregullt të gjithë procesin ligjor, si dhe vetë masën disiplinore të largimit nga detyra. Derisa KLD-ja nuk ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese që lidhet me rishqyrtimin e kërkesës për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve të shkarkuar, ata nuk konsiderohen të ndëshkuar disiplinarisht. Një përfundim i tillë, por që mund të ketë pasoja të rënda, vjen pikërisht nga mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

V. Vendim nr.75, datë 19.4.2002 (V-75/02)

1. Objekt i këtij vendimi është : “Interpretimi përfundimtar i neneve 128, 140, 149, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

-Interpretimin brenda kufijve të objektit të kërkesës të neneve 128, 140 dhe 149, pika 2, të Kushtetutës në këtë mënyrë:

1. Shprehja *“akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”*, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2, të Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit

të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

2. Shprehja *“shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve”* nga Prokurori i Përgjithshëm, parashikuar nga neni 149, pika 2, i Kushtetutës, lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur.

3. Në përcaktimin e procedurave të shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, organet përkatëse duhet të respektojnë rregullat për aq sa parashikohet në Kushtetutë, në ligjet organike të tyre si dhe në aktet e tjera ligjore. Në ndërmarrjen e procedurave për shkarkimin e këtyre funksionarëve kusht thelbësor mbetet respektimi i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës”.

VI. Vendim nr. 76, datë 25.4.2002 (V-76/02)

1. **Objekt i këtij vendimi është :** “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 20, datë 19.3.2002, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe i dekretit nr. 3276, datë 25.3.2002, të Presidentit të Republikës”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 20, datë 19.3.2002, të Kuvendit të Shqipërisë dhe të dekretit nr. 3276, datë 25.3.2002, të Presidentit të Republikës.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kuvendit të Shqipërisë.

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Në rastin e dy vendimeve të sipërpërmendura që janë iniciuar për shkak të procedurave të ndjekura nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm në vitin 2002, rezulton që vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr 75, datë 19.4.2002, është ekzekutuar për sa i përket normimit të procedurave parlamentare që kanë të bëjnë me disa funksione të rëndësishme kushtetuese.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë interpretuar dispozitat kushtetuese për procedurat e shkarkimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, kanë dhënë ndikimin e tyre pozitiv në dispozitat e Rregullores së Kuvendit. Shumë e detajuar është paraqitur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit procedura që duhet të ndiqet në rastet e shkarkimit të Presidentit të Republikës dhe të anëtarëve të organeve kushtetuese. Rregullat procedurale që janë parashikuar në nenet 112 dhe 114 të saj, trajtohen për herë të parë dhe me tepër hollësi.

Vendimet e tjera interpretuese që ka dhënë Gjykata Kushtetuese dhe që lidhen me ngritjen e komisioneve hetimore, me miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, me procedurat për heqjen e imunitetit të deputetit dhe të anëtarëve të Këshillit të Ministrave etj., kanë gjetur, gjithashtu, reflektimin e tyre në disa dispozita të Rregullores së Kuvendit.

Janë krijuar disa struktura të përhershme parlamentare, të cilat kryejnë funksione të vlerësimit dhe të dhënies së mendimit për çështje legislative a të procedurave dhe që lidhen me funksionin vendimmarrës të Parlamentit. Këshilli Legjislativ është një nga këto struktura të reja, i cili, ndërmjet shumë detyrave të tjera, është ngarkuar edhe me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ngritja e një hallke të tillë që të merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është e rëndësishme, sepse shërben si një strukturë efikase dhe operative për të qenë e orientuar në vazhdimësi për qëndrimet që mbahen në jurisprudencën kushtetuese për përmirësimin legjislativ.

Ndërsa, për sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 76, datë 25.4.2002, që lidhet me respektimin e procedurave konkrete të dëgjimit të Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të procesit të parregullt ligjor të zbatuar nga Kuvendi gjatë procedurës së shkarkimit të tij, nuk është ekzekutuar. Për më tepër, që përpara daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, u filluan dhe u përfunduan procedurat për emërimin e Prokurorit të ri të Përgjithshëm.

VII.Vendimi nr. 6, datë 31.3.2006 (V – 6/06)

1.Objekti i vendimit: “Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.”

2. Gjykata Kushtetuese vendosi :

-Pranimin e kërkesës së kërkuesit Enver Memishaj për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë **nga bashkia e Tiranës dhe zyra e përmbarimit, Tiranë.**

-Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare.

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për detyrimin e organeve përkatëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nëpërmjet të cilit kërkuesi ka fituar të drejtat e tij, është mjaft i rëndësishëm në kushtet kur mjaft vendime gjyqësore janë të paekzekutuara. Ky vendim vjen pas qëndrimit që mbajti Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut për këto raste dhe ka rëndësi të dyfishtë, sepse, nga njëra anë e konfirmon ekzekutimin e vendimit gjyqësor si pjesë të procesit të rregullt ligjor dhe, nga ana tjetër, shërben edhe si një nxitje për ekzekutimin e vendimeve të tjera gjyqësore, me qëllim shmangien sa të jetë mundur nga ndëshkimi financiar të shtetit shqiptar me vendime gjyqësore nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Me gjithë sensibilitetin, me keqardhje mund të themi se edhe ky vendim nuk është ekzekutuar ende. Në kushtet kur nuk është ekzekutuar vullnetarisht, dy organe janë të detyruara ta zbatojnë atë: bashkia e Tiranës dhe zyra e përmbarrimit. Nga verifikimi i bërë rezultoi se bashkia e Tiranës nuk pranoi ta ekzekutojë, sepse e konsideron të ekzekutuar, ndërsa përmbarrimi e mban në proces duke zvarritur edhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Mendojmë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i një lloji të veçantë, në këtë rast, sepse detyron organin të ekzekutojë një vendim tjetër, pa shfuqizuar një akt ose një vendim gjyqësor. Rruga e ndjekur nga kërkuesi ka qenë edhe ajo e procedimit penal për shpërdorim detyre ndaj palëve që kanë pasur detyrimin ta ekzekutojnë atë.

VIII.Vendimi nr. 19, datë 3.5.2007

1. Objekti i vendimit: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 1, pika 1; i

nenit 4; i nenit 7, pika 2; i nenit 9; i nenit 10, pikat 1, 2, për sa përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese, si dhe i nenit 20 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj".

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1/1, nenit 4, nenit 7/2, nenit 9, nenit 10/1, 2 dhe nenit 20 të ligjit nr. 9584, dt. 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", vetëm për sa u përket institucioneve të pavarura kushtetuese.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare.

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese vetëm shfuqizon dispozitat e ligjit përkatës dhe, përjashtimisht plotësimin të boshllëkut ligjor nga ligjvënësi, nuk vendos ndonjë detyrim konkret për organet e tjera që të kryejnë veprime për ta ekzekutuar atë. Sidoqoftë, u kërkua të merret informacion nga Drejtoria Juridike e Këshillit të Ministrave për të parë nëse ligji ishte zbatuar edhe për institucionet e pavarura kushtetuese, nga i cili rezultoi se ligji është zbatuar vetëm për institucionet e pavarura të krijuara me ligj, ndërsa institucionet kushtetuese, nga informacioni i marrë prej tyre, e kanë pasqyruar vendimin e Gjykatës Kushtetuese në buxhetet përkatëse.

Nga elementet e arsytimit të këtij vendimi del e qartë se qeveria dhe Kuvendi, në hartimin dhe miratimin e ligjeve që

prekin çështje organizative, funksionale e financiare të institucioneve kushtetuese, duhet të mbajnë parasysh të gjitha këto elemente të pavarësisë së institucioneve kushtetuese, duke respektuar votimin me shumicën e cilësuar prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shumicë e cila është e detyrueshme për miratimin e ligjeve të tyre organike.

IX. Vendimi nr. 29, datë 21.12.2006

1. Objekti i vendimit: e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (bashkia e Tiranës) dhe pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Policia e Ndërtimit).

2. Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes, kompetencave, shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore si dhe shfuqizimin e:

a) neneve: 9 (paragrafi i parafundit), 10, 19, 21, 54 (fjalja “apo Policia e Ndërtimit”), 75/2 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”;

b) neneve: 2 (fjalja “Policia e Ndërtimit varet nga ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit”), 3/3 (fjalja “të marrë vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm”) dhe nenin 6, të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998, “Për Policinë e Ndërtimit”.

3. Interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

<p>1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet bashkisë së Tiranës dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e</p>

Telekomunikacionit dhe Policisë Ndërtimore, duke përcaktuar për çdo rast konkret organin që ka në kompetencë shqyrtimin e çështjeve, objekt i kësaj mosmarrëveshjeje:

a) Shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të ndërtimit, si çështje të planifikimit dhe të menaxhimit urban që përfshihen në konceptin ligjor "*funksionet e veta*", janë kompetencë e plotë dhe ekskluzive e organeve të qeverisjes vendore.

b) E drejta e shfuqizimit të akteve të paligjshme të KRRT-ve që funksionojnë pranë organeve të qeverisjes vendore, është kompetencë e organeve të pushtetit gjyqësor.

c) KRRT-ja është organ i specializuar për urbanistikën që ushtron funksionin dhe kompetencat e tij vendimmarrëse në fushën e planifikimit dhe të menaxhimit urban, nën autoritetin e pushtetit vendor.

ç) Të drejtën për të vendosur për prishjen e vëllimit të punimeve të ndërtuara jashtë projektit të miratuar e ka Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë organeve të qeverisjes vendore.

d) Kontrolli i zbatimit të standardeve teknike mbi territorin është në kompetencë të policisë ndërtimore që vepron si organ i pavarur nga pushteti qendror, por nën autoritetin e organeve të qeverisjes vendore.

2. Të deklarojë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, dispozitat ligjore të mëposhtme:

a) Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën", te neni 9, paragrafi i parafundit, frazën "*Lejet e ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, studimet urbanistike të të cilave miratohen prej tij*", nenin 10, 19, si dhe te neni 54, fjalët "*apo Policia e Ndërtimit*".

b) Në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998, "Për Policinë e

Ndërtimit”, te neni 2, frazën “Policia e ndërtimit varet nga ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit”, si dhe nenin 6. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren zyrtare.

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Ky është një vendim kompleks i Gjykatës Kushtetuese i cili trajton marrëdhëniet ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor dhe caqet e ndërhyrjeve ligjvënëse nën dritën e Kushtetutës. Pajtueshmëria e akteve ligjore është parë në kuptim të nenit 13 të Kushtetutës dhe të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Përmes këtij kontrolli kushtetues, Gjykata ka caktuar se cilit organi qendror apo vendor mund t’i përkasë kompetenca ligjore që lidhet me çdo rast konkret në shqyrtim. Rasti ka rëndësi përtej zgjidhjes së çështjes në fjalë, pasi shërben për vendosjen e standardeve që lidhen me të gjitha çështjet ligjore të trajtuara më lart dhe të cilat duhen mbajtur parasysh nga ekzekutivi dhe legjislativi në rregullime të ngjashme ligjore, në të ardhmen.

Sidoqoftë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i ekzekutuar në tërësinë e tij pas ndryshimeve që iu bënë ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, më 17.12.2007.

X. Vendimi nr 3, datë 11.2.2004

1. Objekti i vendimit: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 86 dhe 87 të Kodit penal”

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

“Rrëzimin e kërkesës” të paraqitur nga Gjykata e Lartë.

3. Mbi ekzekutimin e vendimit

Ky rast u mendua të merret në shqyrtim për shkak të specifikës që ai paraqet. Në parim, vendimet e rrëzimit nuk e

paraqesin nevojën për ekzekutim. Sidoqoftë, në vijim do ta trajtojmë më hollësisht këtë çështje.

5. Procesi i monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Metodologjia e përdorur gjatë procesit të monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese konsistoi në dy drejtime:

a) nëpërmjet përgatitjes së disa pyetësorëve specifikë për çdo rast konkret si edhe

b) nëpërmjet takimeve me personat që merren drejtpërdrejt me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese apo dhe me drejtues dhe ish-drejtues që kanë qenë në funksionet publike në kohën e daljes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë proces u konsiderua e rëndësishme të grupohen vendimet sipas subjekteve që janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë u analizua situata konkrete duke vlerësuar edhe argumentet që dha secili prej tyre për rastet e moszekutimit të vendimeve të kësaj Gjykate.

Vlen të përmendet se, nga analiza e vendimeve në 5 vjet edhe nga bisedat e drejtpërdrejta me institucionet përkatëse, ndihet që ka një sensibilizim të përgjithshëm për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është e rëndësishme për t'u nënvizuar kur specifika e ekzekutimit të këtyre vendimeve qëndron edhe në aspektin se, në dallim nga vendimet e gjykatave të zakonshme, nuk ka një organ të specializuar që të merret drejtpërsëdrejti me zbatueshmërinë e tyre. Sigurisht, Kushtetuta parashikon në mënyrë të qartë karakterin detyrues të këtyre vendimeve, pavarësisht se natyra e disa vendimeve kushtetuese nuk kërkon kryerjen e veprimeve të mëtejshme nga organet përkatëse shtetërore (siç është rasti kur, megjithëse shfuqizohen dispozita ligjore, nuk lind nevoja për plotësimin e ndonjë boshllëku ligjor). Në raste të tjera

organet shtetërore detyrohen të ndërmarrin veprime konkrete për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Këtë detyrim e gjejmë më evident në rastet e vendimeve që kanë konstatuar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në organet gjyqësore apo çdo organ tjetër shtetëror. Sipas këtyre vendimeve, ekzekutimi konsiderohet i realizuar nëpërmjet rifillimit të procedurave ligjore në atë organ ku është konstatuar shkelja e të drejtave të individit për një proces të rregullt ligjor.

Neni 131, germa "f", i Kushtetutës, parashikon se Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në vijim do të trajtohen në mënyrë të grupuar disa nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese që janë marrë gjatë 5 vjetëve të fundit, të lidhura me subjektet konkrete shtetërore, të cilat kanë qenë dhe janë të detyruara kushtetutshmërisht për realizimin e zbatueshmërisë së tyre.

1. Vendime të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me Këshillin e Lartë të Drejtësisë

Gjykata Kushtetuese ka marrë një sërë vendimesh të detyrueshme për t'u zbatuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Rezulton se një pjesë e tyre janë ekzekutuar si nga KLD-ja, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë, si vendimet nr. 43 dhe nr. 48 të vitit 1999. Në këto vendime Gjykata Kushtetuese konkludon se pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj

çështjeje. Fakti që dy gjyqtarë të Kolegjeve të Bashkuara marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse është institucioni ose organi, anëtarë të të cilit ata janë zgjedhur, është një shkak i arsyeshëm që nuk ia largon kërkuesit dyshimin që, në rastin konkret, objektivisht ekziston. Shkelja e parimit të paanshmërisë në gjykim ishte shkak i arsyeshëm për Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar vendimin e Kolegjeve të Bashkuara.

Në vendimin nr. 59, datë 5.11.1999, Gjykata Kushtetuese deklaroi se vlerësimi vetëm i rezultatit të provimit, pa marrë parasysh rezultatet në punë të gjyqtarit dhe kontributin e tij teorik e praktik në fushën juridike, është qëndrim antikushtetues. Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se pamjaftueshmëria profesionale është koncept më i gjerë se mosmarrja e një provimi dhe se ky i fundit nuk mund të jetë tregues i vetëm sintetik i vlerësimit të aftësisë profesionale të gjyqtarit.

Në vendimin nr.11, datë 27.5.2004 [lidhur me të drejtën e ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime dhe, në përfundim, kur vërteton shkelje që pasjellin përgjegjësi disiplinore, të nisë procedimin disiplinor], Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se kjo kompetencë nuk është me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.

Megjithatë, një pjesë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që janë iniciuar me kërkesë të gjyqtarëve të shkarkuar, rezultojnë ende të paekzekutuara. Jo pa qëllim kemi përmendur vendimet e ekzekutuara para vitit 2002 [vit nga i cili kemi filluar të analizojmë të dhënat për studimin], sepse rezultojnë që në këtë periudhë të ketë edhe vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese që nuk janë ekzekutuar nga KLD-ja dhe që kanë sjellë vështirësi të mëdha në ekzekutimin e vendimeve të mëvonshme, për shkak të së njëjtës natyrë çështjeje. Vlen të përmendet kërkesa e paraqitur nga gjyqtari Xh. Balavia etj. ku Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar ankimin e 10 gjyqtarëve, të cilët ishin liruar nga detyra e gjyqtarit me motivacionin për

shkelje të rëndë të disiplinës në punë, për shkelje të etikës së gjyqtarit, për shkelje të ligjit dhe për paaftësi në detyrë.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.15, datë 3.6.1997, ka vendosur detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të rishqyrtojë çështjet e kërkuësve, me qëllim që organi procedues t'u krijonte mundësinë e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes dhe garantimit të procesit të rregullt ligjor.

Pavarësisht se kërkuësit kanë paraqitur në mënyrë të vazhdueshme ankesë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për rishqyrtimin e çështjes së tyre, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, një kërkesë e tillë nuk është marrë ende në konsideratë, duke mbetur ky vendim kushtetues i paekzekutuar.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka arsyetuar se nuk u kthehet më vendimeve të marra prej tij, aq më tepër vendimeve të lëna në fuqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si instancë ankimi, por këta gjyqtarë do të konsiderohen të padënuar disiplinarisht nga Këshilli dhe do të trajtohen në mënyrë të njëjlojtë me personat e tjerë (gjyqtarët apo juristët) që plotësojnë kriteret dhe do të konkurrojnë pa ndonjë pengesë për vendet vakante që do të hapen në të ardhmen.

E njëjta situatë është edhe për sa u përket vendimeve të fundit që janë përmendur tek analiza e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarët A. Kalia, A. Aliaj, M.Mishgjoni dhe A.Capò janë shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë "për kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës".

Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe dërgimin e çështjeve për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në të gjitha vendimet që lidhen me personat e sipërcituar, përqendrohet në drejtimit e mëposhtme:

- gjyqtarët nuk janë njohur me materialet e procedimit

disiplinor;

- nuk janë respektuar rregullat procedurale që lidhen me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur;

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka paragykuar çështjen duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë;

- gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive e subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët e flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta etj.

Gjatë fazës së monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është marrë kontakt me nëpunës të KLD-së për t'u informuar mbi të dhënat, rrethanat apo shkaqet që mund të kenë detyruar KLD-në të mosekzekutojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të ndikuar në mundësinë e rihapjes së procedurës së dëgjimit të gjyqtarëve të shkarkuar me qëllim garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Vështirësia kryesore që i bënte të paekzekutueshme vendimet e Gjykatës Kushtetuese, qëndronte në pamundësinë e rigjykimit nga e para të procedimit disiplinor ndaj tyre, për shkak të mungesës së vendeve vakante për gjyqtarë.

Një nga informacionet më të rëndësishme për këtë problem është marrë nëpërmjet komunikimit me ish-kryetarin e KLD-së, z.Illir Panda. Sipas tij, ky problem ishte diskutuar edhe në KLD, por ishte konsideruar i vështirë rigjykimi i të gjitha rasteve, për shkak se procedimet e padrejta disiplinore të gjyqtarëve, për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, fillonin që nga viti 1994. Pra, shkak kryesor i mosekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që detyronin kushtetutshmërisht KLD-në të rishqyrtonte çështjet, lidhej me numrin jo të vogël të gjyqtarëve të proceduar padrejtësisht. Problemi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ishte diskutuar disa herë në KLD, por pa ndonjë zgjidhje konkrete.

Nga informacionet me gjyqtarët e proceduar rezulton që ata i janë drejtuar me kërkesë KLD-së që çështjet e tyre të trajtohen nga ky organ, në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por ky problem nuk ka gjetur ende zgjidhje.

Sipas informacioneve që janë marrë nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg, rezulton që M.Mishgjoni (ish-gjyqtare) i është drejtuar kësaj Gjykate. Nga materialet e studiuara rezulton se kërkuësja M.Mishgjoni ka pretenduar se i është drejtuar KLD-së më 28 dhjetor 2004 për të rishqyrtuar procedurën disiplinore të shkarkimit nga detyra si gjyqtare, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por, deri në këtë moment, nuk rezulton ende të jetë rishqyrtuar një procedurë e tillë.

Duke e parë KLD-në si një institucion të rëndësishëm në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është marrë kontakt edhe me nënkryetarin aktual të KLD-së, i cili ka konfirmuar se çështja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është në rend të ditës për këtë institucion. Kjo çështje është përfshirë në strategjinë 5-vjeçare të KLD-së, e prezantuar në dhjetor 2007 dhe është futur në rendin e ditës për t'u zgjidhur gradualisht. Nënkyetari prezantoi vështirësitë e krijuara në praktikë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të marra në vite, sepse nuk ka vende vakante tashmë dhe, njëkohësisht, kjo do të shkaktojë edhe pengesa për përfshirjen e elementëve të rinj dhe të përkushtuar për drejtësinë. Pra, vullneti i institucionit për ekzekutimin e vendimeve është i plotë. Shkaku i vetëm i moszekutimit mbetet vështirësia praktike. Sidoqoftë, zbatimi i vendimeve do të bëhet rast pas rasti, por jo në bllok.

2. Vendime të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me organet e pushtetit vendor

Mbi bazën e kërkesës së kërkuësit E.M., me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces

të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me vendimin nr. 6, datë 31.3.2006, Gjykata Kushtetuese ka vendosur: Pranimin e kërkesës së kërkuarit E.M., për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga bashkia e Tiranës dhe zyra e përmbartimit, Tiranë.

Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata Kushtetuese i referohet në mënyrë të veçantë nenit 142/3 të Kushtetutës, sipas të cilit, organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore. Ky detyrim është konkretizuar në dispozitat e Kodit të procedurës civile, nga del se vendimi që ka marrë formë të prerë, është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatat dhe për institucionet e tjera.

Çdo qytetar që i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Çdo çështje duhet të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm dhe mosekzekutimi i vendimit gjyqësor dëshmon se procesi gjyqësor ende nuk ka përfunduar. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e ka zhvilluar juridiksionin e saj duke konkluduar se procesi ligjor nuk mund të konsiderohet i përfunduar, pa u ekzekutuar vendimi gjyqësor dhe pa siguruar individi realizimin e së drejtës së tij.

Sipas vendimit të sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese, mosekzekutimi i vendimit gjyqësor ka ardhur për shkak subjektive, **pasi bashkia e Tiranës dhe zyra e përmbartimit, Tiranë, nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore që ato kanë për vënien në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor konsiston në moskthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës si dhe në mospërfitimin prej tij të pagës përkatëse që i takonte në bazë të ligjit.**

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se procesi gjyqësor për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks në vetvete, përbëhet nga dy faza: njohja a deklarimi i së drejtës që, si rregull, konsiderohet i përfunduar kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë dhe zbatimi i vendimit e përmbushja në fakt e kësaj të drejte.

Pra, nëpërmjet këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar përfundimisht se e **drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor**, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar tashmë praktikën e saj duke u shprehur se **“Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor** e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë” dhe se “asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për detyrimin e organeve përkatëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nëpërmjet të cilit kërkuesi ka fituar të drejtat e tij është mjaft i rëndësishëm në kushtet kur shumë vendime gjyqësore janë të paekzekutuara. Ky vendim vjen pas qëndrimit që mbajti Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut për këto raste dhe merr rëndësi të dyfishtë, sepse e përcakton ekzekutimin e vendimit si pjesë të procesit të rregullt ligjor dhe realizim të së drejtës së individit. Njëkohësisht ai mund të shërbejë edhe si nxitje për ekzekutimin e vendimeve të tjera gjyqësore, me qëllim që të shmanget në maksimum ndëshkimi financiar që mund t'i vijë shtetit shqiptar nga vendimet e kësaj gjykate.

Me gjithë sensibilitetin, me keqardhje mund të themi se ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, që konstaton si shkelje pikërisht mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës

së prerë nga organet shtetërore, ende nuk është ekzekutuar.

Për këtë arsye, gjatë fazës së monitorimit, fillimisht u kontaktua drejtpërdrejt me kërkuesin, i cili shpjegoi maratonën e kërkimeve të tij, tashmë për të realizuar ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, ai pretendoi që zyra e përmbarimit është duke e zvarritur pambarimisht përfitimin prej kërkuesit të së drejtës së tij ligjore të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në kushtet kur nuk është ekzekutuar vullnetarisht ky vendim gjyqësor dhe meqenëse, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, organet që detyrohen të zbatojnë vendimin gjyqësor, janë bashkia e Tiranës dhe zyra e përmbarimit, u kontaktua me përfaqësues të këtyre institucioneve. Nga ana e bashkisë së Tiranës u pretendua se kërkuesi është paguar, duke e konsideruar në këtë mënyrë si të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në fakt, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk konsiderohet i ekzekutuar, sepse kërkuesi nuk është kthyer në punë, ndërkohë që vendimi gjyqësor parashikonte kthimin e tij në punë, ndërsa zyra e përmbarimit pretendon se këtë çështje e ka në proces ekzekutimi, por ende nuk ka arritur ta ekzekutojë. Për këtë arsye, kërkuesi ka kërkuar procedimin penal për shpërdorim detyrë për punonjësin e zyrës së përmbarimit, që nuk ekzekuton vendimin gjyqësor dhe, për pasojë, edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra çështja është në proces dhe ndiqet vazhdimisht nga kërkuesi.

Në të njëjtën linjë arsyetimi Gjykata Kushtetuese ka konkluduar edhe për kërkesën e shtetasit B.H. Me **vendimin nr. 43, datë 19.12.2007, Gjykata Kushtetuese** ka pranuar kërkesën duke konstatuar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga këshilli i rrethit Kurbin dhe zyra e përmbarimit, Lezhë. Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar se “ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza

përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar...Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.”

Gjykata Kushtetuese ka mbajtur të njëjtën linjë duke pranuar në praktikën e saj se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

Pra këto çështje kanë një specifikë, sepse kërkuessit, nga njëra anë ndeshen me mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe, nga ana tjetër, edhe me një mosekzekutim të një vendimi të një autoriteti kushtetues që e konsideron si shkelje të Kushtetutës mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Duket si një rreth vicioz në të cilin vërtitet qytetari që nuk arrin të realizojë të drejtën e tij të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Vendime të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me Kuvendin

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve është një ndër llojet e gjykimit kushtetues që e vendos Kuvendin në pozitën procedurale të subjektit të interesuar. Pikërisht për këtë lloj gjykimi konstatohet se ka shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese, detyrimi për zbatimin e të cilave bie mbi vetë Kuvendin. Proces i ekzekutimit të këtyre vendimeve që kanë të bëjnë me kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve apo akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, paraqet specifikën e vet.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjeve, nga njëra anë janë të vetëkëkutive, sepse e heqin në mënyrë të përhershme normën ligjore nga sistemi juridik shqiptar dhe, nga ana tjetër, ato nuk mund të ekzekutohen pa kryerjen e veprimeve konkrete nga ligjvënësi, të cilat konsistojnë në përmbushjen e detyrimit kushtetues dhe që lidhet me plotësimin e boshllëkut ligjor të krijuar.

Ndërsa në rastin e parë vendimet e Gjykatës Kushtetuese konsiderohen të ekzekutuara që në çastin e botimit të tyre në Fletoren zyrtare dhe nuk përbëjnë problem për zbatueshmërinë e tyre, në rastin tjetër kërkohet të kryhen domosdoshmërisht disa veprime konkrete për ekzekutim nga ligjvënësi.

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me Kuvendin, si subjekt të interesuar, në kuptimin procedural, paraqesin veçori të ndryshme, ku ndikojnë si natyra dhe objekti i çështjes, ashtu dhe qëndrimi që mban vetë Gjykata në përfundim të procesit. Ndryshe paraqitet mënyra e ekzekutimit të vendimit me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së normës juridike, nga vendimi me objekt verifikimin e procedurave parlamentare për shkarkimin nga detyra e funksionarëve të lartë të shtetit. Gjithashtu, vendimet për pranimin e kërkesës nuk kanë të njëjtën mënyrë ekzekutimi me rastet e rrëzimit të kërkesës. Pikërisht për shkak të specifikës që paraqesin këto çështje, është menduar që ato të analizohen të veçuara nga njëra-tjetra.

a) Vendime të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizojnë normën ligjore si antikushtetuese

Pra, problemi që lidhet me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, përqendrohet në ato raste kur vetë vendimi ka krijuar një boshllëk ligjor që është i nevojshëm për t'u plotësuar. Në referim të nenit 78 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet që lindin kërkojnë një rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Në vendime të kësaj natyre, Gjykata Kushtetuese nuk urdhëron ligjvënësin për të plotësuar boshllëkun ligjor, por e orienton atë që gjatë veprimtarisë ligjbërëse të mbajë në vëmendje arsyetimin kushtetues të vendimit të saj. Qëndrimi i mbajtur në vendimin nr 65. datë 10.12.1999, me objekt “Papajtueshmërinë me Kushtetutën e dispozitave të Kodit penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje”, është një standard që është vendosur nga jurisprudenca kushtetuese në raste të kësaj natyre. Për këtë problem, Gjykata Kushtetuese nënvizon se “... me shfuqizimin si antikushtetues të dënimit me vdekje, i përket ligjvënësit shqiptar të rishikojë me frymën e Kushtetutës dhe të këtij vendimi të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me dënimin me vdekje dhe në veçanti dispozitat e Kodit penal, të cilat parashikojnë sanksionet, me qëllim që të harmonizohen në tërësi dënimet që duhen zbatuar ndaj personave që kryejnë këto vepra penale, duke parashikuar dënimet alternative dhe mënjanimin nga këto dispozita konkrete të dënimeve fikse”.

Pra, një vendim për shfuqizimin e një norme ligjore konsiderohet i ekzekutuar në tërësinë e tij kur është arritur të plotësohet boshllëku ligjor i krijuar si rrjedhojë e vendimit. Kjo për faktin se në vendimet e Gjykatës Kushtetuese zbatohet jo vetëm dispozitivi, por dhe elemente të arsytimit të vendimit, kur është e nevojshme. Si, p.sh., me **vendimin nr. 9, datë 26.2.2007**, Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 1,7 (shkronja “a”, “b”) e 9 të ligjit nr 9481, datë 16.2.2006, “Për disa ndryshime në ligjin nr 9418, datë 20.5.2005, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shfuqizimi i dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi, krijon një boshllëk lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet e pleqërisë të ushtarakëve. Bazuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", u rekomandon Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të bëjnë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Pavarësisht se ky studim përfshin periudhën 2002-2007, vlen të përmendet për specifikën që paraqet vendimi nr. 12, datë 21.3.2000, i Gjykatës Kushtetuese, që ka pasur për objekt "shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Gjykata Kushtetuese ka vendosur të shfuqizojë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, frazën që përmban neni 10 paragrafi I i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me përmbajtjen: "... ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve".

Në arsyetimin e vendimit Gjykata Kushtetuese shprehet se: Rregulla për masën e shpërblimit, sipas nenit 10, paragrafi I (çmimi në kohën e blerjes, i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, kur ky indeksim do të llogaritet sipas nenit 27 të ligjit në çastin e hyrjes në fuqi të tij), vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe, pikërisht për këtë shkak, kjo pjesë e nenit 10 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Në përfundim, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se, duke bërë këtë shfuqizim, i takon organit që ka iniciativën ligjvënëse dhe organit ligjvënës që, në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi, të bëjnë plotësimet përkatëse të dispozitës së nenit 10, paragrafi I, të ligjit të sipërcituar.

Në këtë rast ndodhemi para një vendimi të paekzekutuar, pasi boshllëku ligjor i krijuar për shkak të shfuqizimit të dispozitave, objekt shqyrtimi, nuk është plotësuar as me ligjin e ri nr. 9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës". Një boshllëk i tillë ligjor shkakton cenimin e së drejtës së atyre subjekteve, të cilave ligji nuk u zgjidh atë të drejtë që ua njej vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe neni 41 i Kushtetutës.

b) Vendime të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me procedurat parlamentare që ndiqen për shkarkimin nga detyra të funksionarëve të lartë

Vendimi nr. 75, datë 19.4.2002, me objekt interpretimin përfundimtar të neneve 128, 140, 149, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë," është një ndër vendimet nëpërmjet të cilit jurisprudenca kushtetuese ka sanksionuar procedurat që duhet të respektojë Kuvendi i Shqipërisë në rastet e shkarkimit nga detyra të funksionarëve të rëndësishëm kushtetues. Ky vendim ka ndikuar në atë drejtim që Kuvendi të plotësojë korrektësisht rregullat e tij të brendshme në rastet e ushtrimit prej tij, krahas funksionit kryesor, atij të ligjëbërjes, edhe të funksioneve të tjera kushtetuese.

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është konsoliduar qëndrimi se interpretimi i një dispozite kushtetuese mund të kërkohet dhe të realizohet vetëm në ato raste kur ekzistojnë rrethanat që përlligjin dhe imponojnë kryerjen e një interpretimi përfundimtar. Kjo lidhet me ekzistencën e një çështjeje konkrete dhe të interpretimeve të ndryshme të dispozitave kushtetuese, të cilat krijojnë mundësinë e përfshirjes së Gjykatës Kushtetuese në kryerjen e një interpretimi përfundimtar.

Ishte ky vendim që i dha mundësinë kërkuesit, ish-Prokurorit të Përgjithshëm A.R., që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar "Shfuqizimin si antikushtetues

të vendimit nr. 20, datë 19.3.2002, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të dekretit nr. 3276, datë 25.3.2002, të Presidentit të Republikës”.

Me vendimin nr. 76, datë 25.4.2002, Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 20, datë 19.3.2002, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të dekretit nr.3276, datë 25.3.2002, të Presidentit të Republikës, si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kuvendit të Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese, në ushtrim të plotë të kompetencave të saj, shqyrtoi kushtetutshmërinë e procedurave të shkarkimit dhe konkludoi se ato kanë qenë në kundërshtim me parimet kushtetuese. I përkiste Kuvendit të Shqipërisë t'i riparonte këto shkelje duke rishqyrtuar çështjen në përputhje me parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor.

Në informacionet që u mbledhën për mosekzekutimin e këtij vendimi [i cili do të mbetet si një veprim jokorrekt për veprimtarinë e Kuvendit, për arsye se nuk zbatoi një vendim të autoritetit më të lartë në fushën e kontrollit kushtetues], mendimi i përgjithshëm ishte se arsyet dhe qëndrimet politike qenë ato që nuk lejuan ekzekutimin e këtij vendimi, me qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor, nëpërmjet rishqyrtimit të procedurës konkrete të dëgjimit të ish-Prokurorit të Përgjithshëm.

Për më tepër, në rastin konkret, organet më të larta të shtetit, në vend që të respektonin vendimin e Gjykatës Kushtetuese për rishikimin e procedurave parlamentare që lidhen me procesin e rregullt ligjor, konkluduan me emërimin në detyrë të Prokurorit të ri të Përgjithshëm.

c) Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që rrëzojnë kërkesën si të pabazuar

Nuk mbeten jashtë objektit të ekzekutimit të vendimeve edhe rastet kur Gjykata Kushtetuese rrëzon kërkesën duke e lënë situatën ligjore të paprekur. Pavarësisht se dispozitivi i vendimit shprehet për rrëzimin e kërkesës, është pjesa arsyetuese e vendimit që vendos rregulla dhe interpretime kushtetuese, të cilat duhet të zbatohen nga organet përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Një rast interesant, pavarësisht se bën pjesë në vendimet e rrëzimit, por që u pa e arsyeshme të trajtohet në kuadrin e zbatueshmërisë së vendimmarrjes kushtetuese, është vendimi nr. 3, datë 11.2.2004.

Ky vendim është marrë mbi bazën e inicimit të një gjykimi incidental nga Gjykata e Lartë, me objekt “shfuqizimin e neneve 86 dhe 87 të Kodit penal të RSh-së”. Nga shqyrtimi në tërësi i rastit, Gjykata ka vendosur ta rrëzojë kërkesën si të pabazuar. Thelbi i arsytimit të këtij vendimi lidhet me kuptimin që Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, i kanë dhënë rrethit të subjekteve që i nënshtrohen veprës penale të torturës.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se “... për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdo njeri ka të drejtë për të mos iu nënshtrohet torturës apo keqtrajtimit, pavarësisht se është në duart e një zyrtari publik apo të një individi”

Pra, qëndrimi kushtetues dhe konventor për rrethin e subjekteve që përfshihen në veprën penale të torturës është shumë më i gjerë nga ai i zyrtarëve publikë. Ky arsyetim i Gjykatës Kushtetuese ishte shkaku që e konsideroi si të pabazuar kërkesën e paraqitur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, "Për disa ndryshime në Kodin penal" është vendosur dhe ndryshimi i nenit 86 të Kodit penal. Sipas këtij amendamenti ligjor, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe me qëndrimin që mbahet në jurisprudencën ndërkombëtare, subjekte të kësaj vepre penale konsiderohen vetëm personat që ushtrojnë torturë si rrjedhojë e qenies së tyre në funksione publike.

Duke risjellë në vëmendje faktin që në rastin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese zbatueshmëria dhe detyrueshmëria e vendimeve lidhet jo vetëm me dispozitivin, por edhe me arsyetimin e vendimit, rezulton se amendamenti i Kodit penal në veprën penale të torturës për sa i përket rrethit të subjekteve, nuk ka ekzekutuar vendimin nr. 3, datë 11.2.2004. Pikërisht ky amendament i ligjit sjell një interpretim krejt të kundërt për subjektet e veprës penale të torturës, nga qëndrimi që ka mbajtur jurisprudenca kushtetuese.

Nga raste të tilla praktike shtrohen disa pyetje :

a. Krahas vendimeve të pranimit, a mund të konsiderohen si vendime të detyrueshme për t'u zbatuar dhe njëkohësisht për t'u ekzekutuar edhe vendimet e rrëzimit?

b. Prania e një situatë të këtillë, a shtron si nevojë të domosdoshme ekzistencën në Gjykatën Kushtetuese apo në institucione të tjera të ndonjë strukture administrative që duhet të ndjekë në vijimësi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ?

4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me kontrollin e vendimeve të gjykatave

Në kuptim të nenit 145 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat. Neni 77 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", parashikon se vendimet e gjykatave

të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike që nga çasti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është shfuqizuar.

Gjykata Kushtetuese nëpërmjet shfuqizimit të vendimit të gjykatës përkatëse e detyron këtë të fundit të rigjykojë çështjen në fjalë. Nga vendimet e kontrolluara konstatohet se, nga pikëpamja formale, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të ekzekutuara plotësisht nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Problemi qëndron me disa qëndrime kundërshtuese që ka mbajtur veçanërisht Gjykata e Lartë për disa vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 5, datë 7.2.2001, ka shfuqizuar vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, me arsyetimin se kjo gjykatë nuk kishte zbatuar një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, argumenton moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese me tezën se interpretimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese del jashtë juridiksionit të saj dhe se kjo e fundit nuk ka të drejtë të bëjë interpretim të ligjit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vend që të ndryshonin praktikën gjyqësore për problemin konkret, shprehen se nuk ishin të detyruar të zbatonin vendimin e Gjykatës Kushtetuese, sepse kjo e fundit kishte dalë jashtë juridiksionit të saj. Në këtë mënyrë Gjykata e Lartë u shpreh në mënyrë zyrtare hapur kundër një vendimi të Gjykatës Kushtetuese duke krijuar pështjellim në praktikën gjyqësore për qëndrime të ndryshme në lidhje me problemin konkret.

Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese arsyeton se asnjë organ tjetër nuk ka të drejtë të vërë në diskutim vendimet e saj dhe aq më tepër të mos pranojë të zbatojë atë, gjë që do të përbënte një precedent të rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantimit të Kushtetutës.

Gjatë kontrollit që ushtron ndaj vendimeve të gjykatave

të zakonshme, Gjykata Kushtetuese nuk është e lidhur pas interpretimit që ato kanë bërë për zgjidhjen e çështjes konkrete. Nëse ajo vëren se ky interpretim bie në kundërshtim me Kushtetutën, bën një interpretim të ri, i cili ka fuqi detyruese për gjykatën që do të rigjykojë çështjen. Vendimi interpretues që jep Gjykata Kushtetuese, ka efekt të përgjithshëm dhe është detyrues për t'u ndjekur nga gjykatat e tjera. Në rishikimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të sistemit të zakonshëm Gjykata Kushtetuese bën interpretim të dispozitave ligjore, kur këto përmbajnë në vetvete elemente përbërëse të të drejtave themelore të garantuara nga dispozitat kushtetuese. Pikërisht këtu lindin keqkuptime sa u përket kufijve të kontrollit që ajo ushtron duke e konsideruar atë të kapërcyer apo me tendencë për të ndërhyrë në sferën e kontrollit të organeve të tjera.

Duke interpretuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare e, më pas, përmbajtjen e neneve 410 (paragrafi i dytë) e 48 të K.p.penale, Gjykata Kushtetuese u ka dhënë këtyre dispozitave një kuptim të caktuar në mënyrë që me zbatimin e tyre të sigurohet mbrojtja e të drejtave themelore.

Për këtë çështje, problemi është ndërlikuar më vonë me qëndrimet që kanë mbajtur Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë. Në nismën "Për disa ndryshime në Kodin e procedurës penale", Këshilli i Ministrave, ndër të tjera, ka kërkuar edhe amendimin e nenit 410/2 duke shtuar në fund të tij fjalët "...nga i pandehuri". Kuvendi i ka shqyrtuar këto propozime dhe i ka miratuar ato. Këshilli i Ministrave, në vend që të propozonte që neni 410 (parag. i dytë) të amendohej në atë mënyrë që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ka bërë të kundërtën, ka kërkuar që ai të amendohej në mënyrë që të harmonizohej me qëndrimin e Gjykatës së Lartë që është shfuqizuar si antikushtetues.

Këto vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë

përfundimtare, të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim, nuk janë mbajtur parasysh nga Kuvendi me rastin e ndryshimit që i ka bërë nenit 410/2 të Kodit të procedurës penale. Sigurisht, Kuvendi, si organ ligjvënës, ka kompetencën dhe vullnetin e lirë të bëjë ndryshime e plotësime në ligj, por me kusht që ato të mos vijnë ndesh me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Përderisa vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të përmendura më lart, janë mbështetur në Kushtetutë dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, Kuvendi nuk duhej të vepronte në kundërshtim me to.

Në **vendimin nr. 15, datë 17.4.2003**, Gjykata Kushtetuese shprehet se: Në rast se Kuvendi e konsideronte të paplotë ose të paqartë përmbajtjen e nenit 410/2, për ta qartësuar më tej atë e për të siguruar një zbatim të drejtë e unik duhej të tregonte kujdesin e duhur që ndryshimet të prireshin nga gjetja e mjeteve dhe e mënyrave për t'i garantuar të akuzuarit që gjykohet në mungesë, të drejtën e ankimit dhe atë të mbrojtjes, duke zbatuar frymën e vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Kushtetuese. Ndodhur në rrethanat kur Gjykata e Lartë është deklaruar zyrtarisht e publikisht kundër qëndrimit të kësaj gjykate dhe kur Kuvendi i Shqipërisë nxiti një qëndrim që prek të drejtën e ankimit dhe të mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese rikonfirmoi edhe një herë se shfuqizimi i shprehjes së përmendur "...nga i pandehuri" që vjen ndesh me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, përbën një detyrë imperative për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit ligjor.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se: Shtesa në këtë paragraf vjen në kundërshtim me parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal që është i përbërë nga e drejta e ankimit dhe nga e drejta e pjesëmarrjes në gjykim. Për rrjedhojë, amendimi i paragrafit të dytë të nenit 410, nëpërmjet shtesës së bërë, u konsiderua si antikushtetues.

Një vendim tjetër i Gjykatës Kushtetuese është edhe rasti i ankimit të prokurorit S.Z. kundër dekretit të Presidentit të Republikës. Në vendimin e Gjykatës së Lartë që kishte shqyrtuar rastin në fjalë, ndërmjet të tjerave, arsyetohet se: “Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se dekretet e Presidentit të Republikës... të nxjerra në bazë të kompetencave të tij kushtetuese nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, sepse vetë Kushtetuta e ka përjashtuar një mundësi të tillë”. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shkojnë edhe më tej, duke përcaktuar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, duke u shprehur se Kushtetuta “...nuk mundëson kundërshtimin e dekretit as në Gjykatën Kushtetuese, as në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm.”

Ky qëndrim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë kundërshtonte në mënyrë të hapur vendimin nr. 25, datë 13.02.2001, në të cilin Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetues dispozitën e ligjit “Për Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë”, e cila i mohonte prokurorit të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj masës së largimit nga detyra. Me këtë vendim ajo argumentonte se e drejta e prokurorëve për t’u ankuar buron nga Kushtetuta dhe se dallimi që mund t’u bëhet atyre nga gjyqtarët e nëpunësit civilë për të drejtën e ankimit, cenon frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Duke shkuar më tej, kjo Gjykatë, në jurisprudencën e saj, e ka konsideruar të drejtën e ankimit si të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane.

Mbi pretendimin e S.Z. për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështja u paraqit për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, e cila mbajti përsëri të njëjtin qëndrim që kishte mbajtur më parë ndaj së drejtës së prokurorit për t’u ankuar në gjykatë për dekretin e Presidentit të Republikës. Në vendimin nr. 38, datë 23.12.2003, ndërmjet të tjerave, Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara

të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sepse u ka mohuar prokurorëve të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj dekreteve të Presidentit. Kolegjet e Bashkuara i konsiderojnë aktet e Presidentit për largime nga puna si akte me karakter juridiko-kushtetues dhe jo administrativ. Ky arsyetim është në kundërshtim me frymën dhe përmbajtjen e legjislacionit, me jurisprudencën kushtetuese e doktrinën e së drejtës administrative.

6. Mjetet që sigurojnë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Dispozita më e drejtpërdrejtë që përmban ligji nr. 8577, datë: 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në lidhje me çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është neni 81 i tij. Ky nen përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Neni 81 i ligjit të mësipërm synon të vendosë rregulla të prera në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke shkuar deri aty sa Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese i jepet e drejta të gjobisë personat që pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur ky vendim është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Nga kjo dispozitë duket që sistemi i zgjedhur i ngjason atij të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku organi që merret me ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate është Komiteti i Ministrave nëpërmjet strukturave të tij.

Në fakt neni 81 nuk mund të konsiderohet si një dispozitë efektive, për arsye se, në praktikë, nuk rezulton që Këshilli i Ministrave të jetë organi që merret në vijimësi me ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Gjithashtu, edhe Gjykata Kushtetuese, megjithëse e ka të drejtën të caktojë vetë një organ tjetër për ekzekutimin e vendimeve të saj, madje të përcaktojë mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të saj, nuk rezulton ta ketë ushtruar ndonjëherë këtë kompetencë.

Nga sa më sipër dhe në interpretim të nenit 81, rezulton se nga pikëpamja formale nuk mungojnë mekanizmat që nevojiten për të realizuar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por konstatohet se këta mekanizma nuk kanë qenë tepër efektivë.

Ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka rëndësi për funksionimin normal të shtetit të së drejtës. Për natyrën që ka një gjykim kushtetues si dhe vetë vendimi që merr Gjykata Kushtetuese, ekzekutimi i vendimeve jo gjithmonë është i nevojshëm të bëhet në mënyrë të menjëhershme. Pavarësisht nga koncepti kushtetues i detyrueshmërisë dhe vetëzbatueshmërisë së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe duke pasur parasysh faktin që ekzekutimi i tyre mund të kërkojë kohën e nevojshme, prania e ndonjë organi që do të ndiqte në vijimësi mënyrën e ekzekutimit të këtyre vendimeve, mund të ishte një zgjidhje optimale për respektimin e vendimmarrjes së autoritetit më të lartë kushtetues.

Në ligjin nr. 8577, datë: 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", gjenden edhe dispozita të tjera, të cilat, pavarësisht se nuk shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë, shërbejnë për

të vënë në ekzekutim një vendim të Gjykatës Kushtetuese: neni 76 që parashikon efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (mbi efektet ex nunch dhe ex tunch), neni 77 që parashikon efektet juridike ndaj vendimeve gjyqësore si dhe neni 79 që sanksionon fuqinë prapavepruese të vendimeve interpretuese.

Pjesë mjaft e rëndësishme e kuadrit ligjor të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është edhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 87 të kësaj Rregulloreje përcaktohet :**“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren zyrtare.** Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t’i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.”

Sidoqoftë, është e rëndësishme të fokusohet vëmendja në këtë dispozitë të Rregullores, për arsye të problematikës që duket se mbart në vetvete përmbajtja e saj.

-Ndërmjet titullit dhe përmbajtjes së nenit 87 të Rregullores vërehen disa mospërputhje konceptuale. Në përmbajtjen e dispozitës gjenden fraza ose terma që krijojnë keqkuptime dhe keqinterpretime për zbatuesit e saj. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është titulli i dispozitës që përbën dhe pjesën e vlefshme dhe të domosdoshme për t’u parashikuar në këtë Rregullore. “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese *merren në shqyrtim* nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren zyrtare”, -thuhet në përmbajtjen e dispozitës konkrete. Terminologjia e përdorur në këtë dispozitë nuk i përshtatet kuptimit që paraqet në të

vërtetë titulli i saj.

Marrja në shqyrtim e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk duket se është një formulim i drejtë. Kjo frazë e përdorur në këtë dispozitë është e pavend dhe ndoshta e rrezikshme. Edhe në kuptimin gjuhësor, marrja në shqyrtim nënkupton këqyrjen e diçkaje me shumë kujdes dhe me hollësi nga të gjitha aspektet, me qëllim nxjerrjen e një përfundimi të caktuar dhe marrjen e një vendimi konkret.

Asnjë organ nuk ka të drejtë të vlerësojë dhe aq më tepër të marrë në shqyrtim vendimmarrjen kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ky është koncepti kushtetues mbi forcën detyruese dhe efektet e vendimeve të kësaj gjykate.

Në vazhdim të pikës 2 të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit thuhet: "*Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin.*" Të analizosh efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që dihet fuqia e tyre detyruese, do të thotë të shqyrtosh dhe të zbërthesh atë në thellësi dhe në të gjitha elementet përbërëse. Gjithashtu, diskutimi i diçkaje, edhe në kuptimin gjuhësor, është të quash të diskutueshme atë që nuk është plotësisht e vërtetë, e sigurt, e drejtë ose ta vësh atë në dyshim për vërtetësinë që mund të ketë.

Nga ky këndvështrim, *marrja në shqyrtim, analiza* si dhe *diskutimi* që duhet t'u bëhet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli për Legjislacionin, krijon një situatë të ndërlikuar, në mënyrë të veçantë për ata që nuk kanë vizionin e qartë për fuqinë detyruese, përfundimtare dhe të padiskutueshme të vendimmarrjes kushtetuese.

Formulimi i mësipërm i nenit 87 të Rregullores së Kuvendit duket sikur lë në diskrecion të Këshillit për Legjislacionin vlerësimin nëse nevojitet marrja e një nisme ligjvënëse. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se është vetë Kushtetuta dhe ligji organik "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” që përcakton efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimin e të gjitha organeve shtetërore (përfshirë Kuvendin) që të marrin të gjitha masat për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë prizëm, nëse Gjykata Kushtetuese shfuqizon një ligj të caktuar, atëherë Kuvendi duhet të marrë masa për miratimin e një ligji tjetër në përputhje me Kushtetutën, sigurisht, duke debatuar dhe duke analizuar çështjen, por pa cenuar në asnjë rast vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Parashikimi në Rregulloren e Kuvendit të një Këshilli për Legjislacionin, i cili funksionon vetëm për vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Kuvendin, ngre pyetjen:

A duhet të ketë çdo institucion një strukturë të caktuar për të ndjekur zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që kanë të bëjë me të?

Cilët do të ishin mekanizmat më të efektshëm për të realizuar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?

REKOMANDIME

1. Në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ligjvënësi mund t'i japë shumë më tepër hapësirë për normimin juridik, me rregulla më të plota e të qarta për të rritur efektivitetin e ekzekutimit të vendimeve kushtetuese. Një kërkesë e tillë bëhet e domosdoshme kur konstatohet se :

a. Neni 81 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", që ngarkon Këshillin e Ministrave për t'u marrë me sigurimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton të ketë qenë dispozitë efektive.

b. E drejta e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për të dënuar me gjobë deri në 100.000 lekë personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës, jo vetëm nuk i përshtatet funksionit të tij kushtetues, por, nga ana tjetër, nuk ka rezultuar të ketë qenë mjet efektiv për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

c. Pavarësisht se ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 81, pika 3, i ka njohur Gjykatës Kushtetuese të drejtën për të caktuar vetë një organ për t'u marrë me zbatimin e vendimit të saj, apo edhe për të caktuar mënyrën e ekzekutimit, në praktikë nuk rezulton të jenë zbatuar rregulla të tilla procedurale.

2. Këto rregullime ligjore jo vetëm i japin të drejtë, por njëkohësisht mbartin edhe një detyrim për Gjykatën Kushtetuese për të shfrytëzuar me më shumë efektivitet mjetet me të cilat është pajisur nga ligji, me qëllim shmangien e atyre pak rasteve të moszbatimit të vendimeve të saj. Në këtë aspekt, mbi bazën e këtij rregullimi ligjor ekzistues, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet interpretimit të dispozitave përkatëse për ekzekutimin, është e nevojshme të bëjë sa me

efektive mënyrat e ekzekutimit të vendimeve kushtetuese.

3. Në Rregulloren e Kuvendit nuk rezulton të jetë parashikuar ndonjë dispozitë tjetër që të përcaktojë rregulla që ndihmojnë në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Pasqyrimi vetëm në një dispozitë të Rregullores së Kuvendit (neni 87) i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (dispozitë e cila është e diskutueshme dhe mbart problematikë për nga efektet që mund të sjellë në zbatim), nuk plotëson kuadrin e nevojshëm që ndihmon në vetëzbatueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim nevojitet një amendim i dispozitave të veçanta të Rregullores së Kuvendit që e lehtësojnë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

4. Krahas vendimeve të pranimit, duhen konsideruar si vendime të detyrueshme për t'u zbatuar dhe njëkohësisht për t'u ekzekutuar edhe vendimet e rrëzimit. Trajtimi në këtë mënyrë edhe i vendimeve të rrëzimit shtron si nevojë të domosdoshme ekzistencën në institucionet shtetërore apo edhe në vetë Gjykatën Kushtetuese të ndonjë strukture që të ndjekë orientimet kushtetuese të pasqyruara në pjesën arsyetuese me qëllim azhurnimin e tyre në veprimtarinë normuese të organeve shtetërore.

5. Nga analiza e vendimeve kushtetuese, por dhe nga kontaktet me institucionet përkatëse shtetërore konstatohet një ndjenjë sensibiliteti e përgjithshme për vetëzbatueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht mosekzistencës së një organi të specializuar për ekzekutimin e këtyre vendimeve. Megjithatë Kushtetuta parashikon në mënyrë të qartë karakterin detyrues të këtyre vendimeve, një gjendje e këtyre vendimeve, një nivel të ekzekutimit të vendimeve kushtetuese e imponon ngritjen e ndonjë strukture administrative të posaçme që të ndjekë në vijimësi mënyrën e zbatimit të tyre.

